



## KUJTESË

PËR VËPRIMET QË DUHET TË  
KRYEJNË QYTETARËT NË RAST  
FATKEQËSIE NATYRORE

2022

# **PËRMBYTJE**

## **Cfarë duhet të bëjmë para përmytjes:**

- 1- Të praktikojmë me familjen planet e emergjencës dhe evakuimit për të qenë gjithmonë të gatshëm.
- 2- Të përgatisim një paketë me ushqime, ujë dhe disa veshje rezervë për të gjithë pjesëtarët e familjes.
- 3- Të mbajmë gjithmonë kutinë e ndihmës së shpejtë në vende të sigurta bashkë me dokumentet e rëndësishme për t'i marrë me vete në një moment rreziku.
- 4- Të vendosim pajisjet elektrike dhe ushqimet e emergjencës në vende dhe katet e sipërme të ndërtesës ku nuk mund të preken nga përmytja.

## **Cfarë duhet të bëjmë gjatë përmytjes:**

- 1- Të largohemi nga shtëpia që rrezikohet dhe kur nuk mundemi të ngjitemi në pjesën më të lartë të saj.
- 2- Të ndihmojmë fëmijët të moshuarit dhe të sëmurët për të shpëtuar nga mbytja.
- 3- Të qëndrojmë larg vendeve të rrezikshme si puseta, kanale, ujëmbledhës, pasi vrulli i ujit mund të na marrë duke rrezikuar jetën tonë.
- 4- Të jemi gjithmonë të kujdesshëm dhe të mos ecim përmes ujërave të rrëmbyeshëm sepse mund të rrëzohemi, bllokohemi apo objekte të ndryshme mund të na dëmtojnë trupin tonë.
- 5- Kur lajmërohemi për evakuim (shpërngulje) duhet të dëgjojmë me vëmendje dhe të zbatojmë këshillat dhe udhëzimet e autoriteteve që menaxhojnë emergjencat dhe të ndjekin menjëherë atë rrugë që kanë përcaktuar për evakuim.
- 6- Nëse jemi duke drejtuar mjetin, ndalojmë dhe parkojmë në një vend ku nuk preket nga përmytja.

## **Cfarë të bëjmë pas përmytjeve:**

- 1- Të ktheheni në banesë pasi të kenë urdhëruar drejtuesit e emergjencës.
- 2- Të mos takojmë asnjë çelës elektrik pa u bindur për sigurinë e rrjetit.
- 3- Të kontrollojmë rrëzimin e mureve, shkallëve, dyerve apo kanalet e ndryshme të shkarkimeve të ujërave dhe të lajmërojmë autoritetet për dëmtimet e ndryshme të banesës.
- 4- Asnjëherë mos të përdorni ujin për pirje që vjen nga rrjeti i ujësjellësit sepse mund të jetë i infektuar. Kur është e domosdoshme duhet ta ziejmë atë.
- 5- Të mos përdorim ushqimet e lagura nga përmytja sepse mund të sëmuremi.
- 6- Të përdorim mjete rrethore për të pastruar banesën nga uji ose kur keni mundësi mund të përdorim pompa dore ose motopompa, të ndihmuar nga specialistët.

# DËBORA

## **Çfarë duhet të bëjmë para bllokimit nga dëbora:**

- 1- Të sigurojmë ushqimin për familjen dhe kafshët shtëpiake të paktën për dy javë.
- 2- Të sigurojmë nga ngrirja rrjetin e tubacioneve të ujit të pijshëm.
- 3- Të sigurojmë mjetet e ngrohjes për të gjithë periudhën e dimrit.
- 4- Të pastrojmë vazhdimisht çatitë e banesave nga shtresat e dëborës.
- 5- Të sigurojmë veshje të trasha për fëmijët dhe të moshuarit.
- 6- Të kemi një paketë të ndihmës së shpejtë për çdo rast emergjent.
- 7- Të sigurojmë një aparat telefoni celular dhe një bateri për atë.
- 8- Të kemi numrat e shërbimeve emergjente një nga telefonat e linjave celulare.
- 9- Të sigurojmë një mjet ndriçimi me bateri, të pavarur nga rrjeti elektrik.

## **Çfarë duhet të bëjmë gjatë bllokimit nga dëbora:**

- 1- Të sigurojmë vazhdimisht ngrohje të banesës.
- 2- Të sigurojmë ndriçim të pandërprerë në dhomën ku kemi të moshuar, fëmijë apo persona të sëmurë.
- 3- Të vendosim kontakte me të afërmit dhe t'i ndihmoni në rast fatkeqësie.
- 4- Të mbajmë të hapur rrugën në oborret brenda shtëpisë.
- 5- Të kontrollojmë vazhdimisht kafshët shtëpiake dhe të sigurojmë ngrohjen për ambientet e tyre.
- 6- Të jemi të informuar në çdo kohë për situatën dhe veprimet e ekipit të menaxhimit të emergjencës në bashkinë tonë.
- 7- Të ndihmojmë ekipet e emergjencës kur kjo gjë të kërkohet nga drejtuesit e tyre dhe njësitë vendore.

## **Çfarë duhet të bëjmë pas bllokimit nga dëbora:**

- 1- Të pastrojmë çatitë e banesave nga dëbora.
- 2- Të sigurojmë të afërmit nga rrëshqitja në dëborë.
- 3- Të ndihmojmë në hapjen e rrugëve këmbësore dhe automobilistike.
- 4- Të punojmë së bashku me komunitetin për të ndihmuar ekipet e emergjencës.
- 5- Të krijojmë kushte për strehimin e ekipeve të emergjencës, kur kjo gjë kërkohet nga drejtuesit e tyre dhe të njësisë vendore.
- 6- Të informojmë ekipet e emergjencës për familjet që kanë probleme në territorin e lagjes sonë.
- 7- Të ndihmojmë të sëmurët dhe personat me aftësi të kufizuara.
- 8- Të mos pengojmë veprimet e forcave të emergjencës në realizimin e objektivave të tyre për dhënien e ndihmës për komunitetin.

# TËRMETI

## **Çfarë duhet të bëjmë përpara një tërmeti:**

- 1- Nëse nuk jeni të bindur që banesa juaj është e projektuar që mund të përballojë një tërmet atëherë me ndihmën e një specialisti mund të përforconi muret mbajtëse dhe lidhjet mes mureve dhe soletës.
- 2- Mundohuni të shmangni vendosjen e mobilieve të rënda.
- 3- Siguroni mirë në mure, raftet, bibliotekat, piktura dhe pasqyrat.
- 4- Gjithmonë vendosni objektet më të rënda në katet e poshtme të rafteve.
- 5- Në kuzhinë siguroni që dyert e rafteve ose sirtarëve ku mbani pjatat, gotat, filxhanët dhe thikat të mos hapen në rast të lëkundjeve të tërmetit.
- 6- Mësoni ku janë dhe si të mbyllni rubinetat e gazit, ujit dhe automatit kryesor të energjisë elektrike.
- 7- Përcaktoni pikat më të sigurta të banesës, ku të strehoheni në rast tërmeti: poshtë kasave të dymave, në cepat e mureve ose poshtë tavolinës dhe krevatit.
- 8- Mbani gjithnjë në shtëpi një kuti të ndihmës së shpejtë. Një elektrikë dore, një radio me bateri. Për këto sigurohuni që çdo pjesëtar i familjes të dijë ku këto ndodhen.
- 9- Eliminoni çdo situatë që në rast tërmeti mund të përbëjnë rrezik për ju dhe familjen tuaj.

## **Çfarë duhet të bëjmë gjatë një tërmeti:**

- 1- Nëse gjendeni në një vend të mbyllur shkoni menjëherë poshtë traut të banesës, në kasën e dymave ose pranë një muri mbajtës.
- 2- Duhet të keni kujdes nga gjërat që mund t'ju godasin si xhama, mobilje etj.,
- 3- Kini kujdes në përdorimin e shkallëve. Shpesh herë janë pak rezistente dhe mund të dëmtohen.
- 4- Është mirë të shmangni përdorimin e ashensorit. Mund të bllokohet ose të jetë dëmtuar.
- 5- Kini kujdes nga pasoja të tjera nga tërmeti, si shembjet e urave, rrëshqitjet e terrenit dhe rrjedhjet e gazit.
- 6- Nëse jeni në mjedis të hapur largohuni nga ndërtesat e larta, pemët, shtyllat elektrike pasi mund të goditeni nga materiale të ndryshme..

## **Çfarë duhet të bëjmë pas tërmetit:**

- 1- Sigurohuni që personat rreth jush janë në gjendje të mirë shëndetësore.
- 2- Dilni me kujdes nga banesat.
- 3- Mos harroni të vishni këpucët, pasi jashtë mund të ketë xhama dhe sende të tjera dhe mund të dëmtoheni nga këmbët.

# ZJARRI

## **Si të parandalojmë një zjarr në banesë:**

- 1- Mos pini cigare në krevat. Mos lini sende, rroba mbi sobë ose furnela enë kuzhine etj.
- 3- Mbani larg sobës dhe furnelave material që mund të digjet shpejt ose që stimulon zjarrin.
- 4- Me teknikë të fushës kryeni herë pas here kontrollë të impiantit të ngrohjes nëse keni në banesë, atë të gazit për gatim dhe sistemit elektrik të kuzhinës.
- 5- Mbani larg fëmijëve shkrepëse dhe çakmak.
- 6- Mos mbani lëngje të djegshme pranë burimeve të nxehtësisë.

## **Çfarë të bëjmë në rast zjarri në banesë:**

- 1- Nëse një enë kuzhine merr zjarr, për ta fikur mjafton të vendosni një kapak në mënyrë për të mbytur flakët.
- 2- Nëse rrobat tuaja kanë marrë zjarr mos filloni të vraponi (ajri shton flakët). Duhet të përpiqeni të hiqni rrobat ose të fikni flakët duke u rrokullisur në tokë ose duke u mbështjellë me një batanije.
- 3- Nëse një pajisje elektrike merr zjarr, përpara se të tentoni ta fikni, ulni automatikisht kryesor të energjisë elektrike. KUJDES! Mos përdorni ujë për të fikur një zjarr me origjinë elektrike pasi mund të dëmtoheni nga rryma elektrike.
- 4- Mos përdorni ujë kur zjarri vjen si pasojë e naftës ose benzinës, pasi këto lëngje qëndrojnë mbi ujë dhe në këtë mënyrë ekziston mundësia që zjarri të përhapet edhe në ambiente të tjera.

## **Si të parandalojmë një zjarr në pyje:**

- 1- Mos hidhni në asnjë rast bishtat e cigareve në zona ku ka bar pasi ekziston mundësia për nisjen e një zjarri.
- 2- Mos ndizni zjarre në pyje. Nëse ndizni zjarr në kamping mos u largoni pa u siguruar që është fikur tërësisht.
- 3- Nëse parkoni automjetin sigurohuni që marmita e makinës tuaj mos jetë në kontakt me barin e thatë pasi marmita e nxehtë mund të ndezë flakët.
- 4- Mos digjni pa marrë masat e nevojshme degët e pemëve ose gjethet pasi në pak minuta zjarri mund të përhapet.

## **Çfarë të bëjmë gjatë zjarrit në pyje:**

- 1- Nëse vëreni një zjarr ose dhe vetëm tym menjëherë telefononi shërbimin zjarrfikës për të dhënë alarmin. Mos mendoni se njerëz të tjerë e kanë bërë këtë para jush. Jepni vendndodhjen e saktë të zjarrit.
- 2- Kërkoni një rrugë të sigurt për t'u larguar, një rrugë ose brigjet e një lumi.
- 3- Mos ndaloni në vende ku drejt jush fryn era, pasi mund të mbeten të bllokuar mes flakëve.
- 4- Shtrihuni në tokë në një vend ku bimësia është e rrallë, pasi tymi ka tendencë të shkojë lart dhe në këtë mënyrë shmangni thithjen e tymit.
- 5- Nëse jeni i rrethuar nga flakët dhe nuk keni rrugë tjetër mundohuni të gjeni vendin ku flakët janë më të ulëta dhe kaloni në anën tjetër.
- 6- Zjarri nuk është një spektakël. Mos qëndroni në rrugë duke e parë. Mund të bllokoni ose të vononi qarkullimin e mjeteve të emergjencave.